



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 4137 prot.

Shkodër, më 26.11.2021

VENDIM

Nr. 360, datë 26.11.2021

"Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, gërma "r", Senati akademik, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit të Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit (materiali bashkalidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. dr. Suzana COLEMI





UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR GARANTIMIN E
STANDARDEVE TË CILËSISË NË USH DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

Baza ligjore

- Ligji Nr.80/2015 datë 22.7.2015 “Për asimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 103.
- Statuti i USH-së, Neni 18 dhe 23.

Neni 1

Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit (Komisioni)

Dispozita të përgjithshme

- 1.Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit ngrihet pranë USH-së, me mandate 2-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 2.Detyrat e Komisionit janë të përcaktuara në Statutin e USH-së.
- 3.Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik. krijimi i Komisionit bëhet me vendim të Senatit Akademik.
- 4.Komisioni përbëhet nga staf akademik me kohë të plotë nga secili fakultet si dhe nga student/studentë dhe përfaqësues nga drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve.
- 5.Në mbledhjen e parë të tij Komisioni zgjedh kryetarin dhe sekretarin.



Neni 2

Misioni i Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit

1. Komisioni ka për detyrë monitorimin e sigurimit të cilësisë në USH dhe në njësitë kryesore, vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit si dhe hartimin dhe miratimin e procedurave, kritereve dhe formateve të vlerësimit të cilësisë akademike në USH dhe në njësinë kryesore.

Neni 3

Funksionimi i Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit

1. Komisioni harton planin vjetor të punës.
2. Plani vjetor i punës hartohet nga kryetari dhe miratohet në mbledhje të veçantë nga anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni kërkon informacion në formë shkresore nga të gjitha strukturat në USH, me qëllim realizimin e cilësisë.
4. Komisioni parashikon takime periodike me NjSBC-të e fakulteteve, me studentët dhe stafin akademik dhe joakademik, me qëllim monitorimin e punës dhe të problematikave të mundshme.

Neni 4

Mbledhjet e Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit

1. Komisioni zhvillon mbledhje bazuar në planin e punës së tij.
2. Komisioni zhvillon mbledhje bazuar në lajmërimin e bërë nga sekretari i tij, firmosur nga Kryetari. Mbledhjet thirren nga Kryetari.
3. Në raste të veçanta, mbledhjet mund të thirren edhe nga çdo anëtar tjetër i Komisionit. Thirrja e mbledhjes bëhet me kërkesë të veçantë drejtuar sekretarit, në të cilën shpjegohen arsyet e thirrjes së saj. Pas miratimit nga Kryetari, sekretari njofton Komisionin për ditën kur do të zhvillohet mbledhja (jo më pak se 5 (pesë) ditë).
4. Në rast se një anëtar i Komisionit nuk paraqitet në mbledhje, paraprakisht ai duhet të njoftojë kryetarin për arsyet e mungesës dhe ta motivojë atë.
5. Mbledhja zhvillohet kur është e pranishme më shumë se gjysma e anëtarëve.
6. Komisioni i merr vendimet me 2/3 e anëtarëve të Komisionit.



Neni 5
Miratimi dhe rishikimi i Rregullores

1. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik pasi të jetë miratuar paraprakisht nga Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit. Komisioni e miraton atë me 2/3-at e anëtarëve të tij.
2. Rishikimi i Rregullores dhe çdo ndryshim i saj miratohet fillimisht në Komision dhe, më pas, në Senatin Akademik të USH-së.
3. Subjektet që gëzojnë të drejtën të propozojnë ndryshime të pjesshme ose rishikimin e plotë të Rregullores së Komisionit janë anëtarë të Komisionit, secili prej anëtarëve, si dhe Senati Akademik.

Neni 6
Hyrja në fuqi

1. Rregullorja e Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.
2. Nëse Senati Akademik konstaton mospërputhje të Rregullores me Ligjin Nr.80/2015 datë 22.7.2015 “Për asimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me Statutin e USH-së, ia kthen atë për ripunim Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit.
3. Komisioni brenda 1 (një) muaji nga kthimi i Rregullores rishqyrton dhe miraton ndryshimet e propozuara dhe ia dërgon Senatit akademik për miratim.
4. Ndryshimet në rregullore miratohen me të njëjtat procedura.

Miratuar me vendim të Senatit Akademik të USH-së Nr. 360, datë 26/11/ 2021.

